



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2024

**VENDIM**

**Nr. 49, datë 31.01.2024**

**PËR PËRFUNDIMIT PARA AFATIT TË TRANSFERIMIT TË  
PËRKOHSHËM ME PËLQIM PËR GJYQTARIT Z. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 46, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe bazuar në Vendimin të tij nr. 530, datë 11.10.2023, “Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të gjyqtarit z. {...}”, në kushtet kur verifikohet që gjyqtari i transferuar me pëlqim, të jetë transferuar për shkak të suprimimit të pozicionit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

**VENDOSI:**

1. Përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim, për gjyqtarin z. {...}.
2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 31.01.2024.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**